



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 1361/2 Prot.

Fier, më 09.11. 2021

THIRRJE E VECANTË 12

E VENDEVE TË LIRA ME AFAT TË CAKTUAR PËR PUNONJËS TË NJËSISË SË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL NË INSTITUCIONET PUBLIK TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (IPAP) NË ZVAP NË VARESI TË DRAP FIER

Në zbatim të Ligjit nr.69 / 2012 “ Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë “i ndryshuar, VKM nr.99 datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e njesisë së shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social” si dhe bazuar në vendet e lira të punës të deklaruara nga ZVAP-të në varësi të DRAP Fier, bën thirrje të vecantë për vende të lira të punës me afat të caktuar, për punonjës në njësinë e shërbimit psiko-social (psikolog/ punonjës-social) në institucionet publike të arsimit parauniversitar IPAP, në ZVAP-të në varësi të DRAP Fier.

I. Kriteret për tu punësuar në shërbimin psiko-social

A. Kërkesat e përgjithshme që duhen plotësuar për punësim në pozicionet e mëposhtme janë:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
4. Të mos jetë dënuar për vepra penale dhe të mos ketë proces penal të hapur në prokurori apo gjykatë;
5. Të mos jetë marrë më parë masë largimi nga punët e mëparshme dhe të mos ketë masa të tjera administrative apo vërejtje në fuqi.

B. Kërkesat e veçanta që duhen plotësuar për punësim në pozicionet e mësipërme janë:

1. Të jetë pajisur me diplomën e ciklit të parë, në fushën përkatëse (përbën avantazh ata që janë drejt përfundimit të masterit)
2. Njohuri bazë në kompjuter;
3. Aftësi komunikuese dhe punës në grup.

II. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

A. Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Përshkrimi i edukimit dhe i karrierës profesionale- jetëshkrimin (Curriculum vitae) sipas shtojcës 3 të Urdhrit nr.313, datë 20.10.2020 (e detyrueshme);
2. Kërkesë për punësim në zyrën arsimore që dëshiron për pozicionin psikolog / punonjës social (e detyrueshme);

3. Raport mjekoligjor i tri muajve të fundit;
4. Deklaratë për verifikimin e vërtetësisë së dokumentave të paraqitura nga kandidati sipas shtojcës 4 të Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 (e detyrueshme);
5. Formular vetëdeklarimi i gjendjes gjyqësore sipas shtojcës 5 të Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 (e detyrueshme);
6. Fotokopje e librezës së punës e noterizuar (nëse ka);
7. Kopje e njehsuar me origjinalin e diplomës Bachelor , vërtetimit/listës së notave të studimeve të larta të ciklit të parë Bachelor (e detyrueshme);
8. Listë notash e noterizuar e ciklit master (nëse ka master).
9. Leje për ushtrimin individual të profesionit (licencë, nëse ka);
10. Kopje e njehsuar me origjinalin e arsimit shtesë dhe listës së notave .
11. Fotokopje e kartës së identitetit ose certifikatë personale (e detyrueshme);
12. Nëse është i punësuar, vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi ose vetdeklarim në rastin kur nuk është i punësuar (detyrueshme).

B. Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në DRAP Fier përkatëse brenda afatit 10.11.2021- 12.11.2021.

III. Vlerësimi i dokumentacionit do të bëhet nga komision i DRAP Fier.

- IV. Bazuar në renditjen përfundimtare, DRAP Fier do të ndjek procedurat e emërimit sipas përcaktimeve të Urdhërit nr.313/2020.
- V. Në tabelën bashkëlidhur do të gjeni vendet e lira sipas ZVAP-ve përkatëse.

DREJTORI

BRUNILDA DHAMO



Nr	DRAP	ZVAP	Shkolla ku emerohet	Shkolla/shkollat qe mbulon	Nr I nxënësve	Total nxënësve	psikolog/punonjes social	Me afat/pa afat
1	FIER	FIER	9 VJ "Andon Profka" Seman	"Lili Stavre" Topojë "Ymer Xhafa" Dermenas "Kostandin Peto" Çlirim "Kutbi Vruzhaj" Levan	129 118 129 90	626+4AK	Psikolog/punonjës social	Me afat
2	FIER	MALLAKASTËR	9 VJ "Besëlidhja" Ballsh	"Besëlidhja" "Ramis Aranitasi" Aranitas "Muharrem Zotaj" "Ali Maskaj" Lofkënd Cfir "Beqo Caushi" Metoh	318+5 AK 47 31 33+1AK 12 11 66 23+1AK	541+7AK	Psikolog/punonjës social	Me afat
3	FIER	LUSHNJË	Gjimnazi"18 Tetori"	Gjimnazi"18 Tetori"	621+2AK	621+2 AK	Psikolog/punonjës social	Me afat
4	FIER	PËRMET-KËLCYRË	Gjimnazi " Sejfulla Malëshova" Këlcyrë	Gjimnazi " Sejfulla Malëshova" 9VJ " Kamber Benja" Këlcyrë	116+1AK 304+12 AK	420+13 AK	Psikolog/punonjës social	Me afat
5	FIER	SARANDË-DELVINË-KONISPOL	Gjimnazi "Hasan Tahsini" Sarandë	Gjimnazi "Hasan Tahsini"	631	631	Psikolog/punonjës social	Me afat
6	FIER	SARANDË-DELVINË-KONISPOL	9VJ "Adem Sheme" Sarandë	9VJ "Adem Sheme" Sarandë	1074+18 AK	1074+18 AK	Psikolog/punonjës social	Me afat
7	FIER	SARANDË-DELVINË-KONISPOL	SHMB "Bide Sejko" Konispol	shmb "Bide Sejko" Konispol 9VJ Xarrë 9VJ Vrinë 9VJ "Rait Bajo" Shalës	310+1 AK 95+1 AK 64 99	568+1 AK	Psikolog/punonjës social	Me afat
8	FIER	ROSKOVEC	9 VJ "Alush Grepcka" Roskovec	9 VJ "Alush Grepcka" Roskovec 9VJ ' Ajet Toska" Suk2		585	Psikolog/punonjës social	Me afat
9	FIER	GJIROKASTËR-LIBOHOVË	9 VJ "Koto Hoxhi" Gjiokastër	"Koto Hoxhi" Gjiokastër	934+ 14 AK	934+ 14 AK	Psikolog/punonjës social	Me afat
10	FIER	VLORË-HIMARË	9VJ "Muço Delo" Vlorë	9VJ "Muço Delo" Vlorë	443+13 AK	443+13 AK	Psikolog/punonjës social	Me afat
11	FIER	VLORË-HIMARË	9-VJ "Pano Nikolla Meniko" HIMARE	GJIMNAZI SPIRO GJIKNURI 9-VJECARE HIMARE VARTESE "GJIK BIXHILI" Dhërmi VARTESE "NIKO ALEKSI" Dhërmi VARTESE" MEMO METO" Kuç SHMB " QAZIM PALI " Borsh VARTESE" VASIL LACI" Lukovë 9-VJECARE LUKOVE VARTESE "KOZMA PAPADHIMA" Borsh SHMB "HYSEN ÇINO" Vranisht	81 131 46 19 44 146 6 50 24 106	653	Psikolog/punonjës social	Me afat